



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI - OPSTINA VUCITRN



Duke vendosur në çështjen administrative, sipas Kërkesës për Rishqyrtim të subjektit në procedurë: Grandelite L.L.C, IOT SMART & GREEN SHPK dhe UDHA SHPK, Autoriteti Kontraktues - Drejtoria për Prokurim Publik e Komunës së Vushtrrisë, pas mbajtjes së seancës jo publike të shqyrtimit të kërkesës të subjektit në fjalë, në bazë të nenit 108/A pika 6 lidhur me pikën 10 paragrafi 10.1 të Ligjit për Prokurimin Publik në Kosovë nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, më datën 24.06.2024, merr këtë:

VENDIM

1. Refuzohet plotësishtë e pabazë Kërkesa për rishqyrtimin lidhur me Njoftimin Letër për Tenderuesin e eliminuar, të subjektit në procedurë: Grandelite L.L.C, IOT SMART & GREEN SHPK dhe UDHA SHPK për aktivitetin e prokurimit me titull: Ndertimi i rrugëve me kubza betoni (kalldërm) RrPandeli Sotiri Shem Nallbani dhe Hoxhë Kadri Prishtina , Nr.i prokurimit: VU644-24-3363-5-2-1.

2. Vërtetohet si i bazuar Vendimi i Autoritetit Kontraktues - Drejtorisë Komunale për Prokurim Publik për vazhdimin e aktivitetit në bazë të Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të dt. 18.06.2024.

Arsyetim

Autoriteti Kontraktues - Drejtoria Komunale për Prokurim Publik (në tekstin e mëtejme A.K.) në bazë të rezultatit nga procesi i ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve ka marrë vendim që ta rekomandoi për dhënie të kontratës: Grupin e OE Gurëbardhi Shph ^ AL Beton Shpk me seli në Klinë, ndërsa Grupin e OE Grandelite L.L.C, IOT SMART & GREEN SHPK dhe UDHA SHPK (në tekstin e mëtejme Ankuesin) ta renditë në mesin e O.E. të eliminuar, bazuar në procedurën e zbatuar.

Njoftimi mbi Vendimin e A.K. si dhe Njoftimi letër për tenderuesin e eliminuar për Ankuesin janë dërguar për publikim në platformën elektronike më dt. 18.06.2024, bazuar në dispozitat e nenit 42 të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik.

Në Kërkesën për rishqyrtim, Ankuesi konsideron se, duke vendosur si në Vendimin e cekur më lartë, A.K. ka shkelur dispozitat e LPP-së, dhe nenet e pretendura,

Autoriteti Kontraktues pasi i shqyrtoi një nga një pretendimet e Ankuesit të parashtruara në Kërkesë për Rishqyrtim dhe vlerësimit të provave në shkresat e lëndës, gjeti se Kërkesa e Ankuesit është e pabazë, për arsye se:

1. Vendimi për ta rekomanduar për dhënie të kontratës OE: Grupin e OE Gurëbardhi Shph ^ AL Beton Shpk me seli në Klinë, është marrë në mes tjerash edhe në zbatim të nenit 59 të LPP-së, sepse një tender do të konsiderohet i përgjegjshëm dhe i pranueshëm vetëm nëse përmbushë kërkesat administrative, profesionale dhe minimalisht ato teknike dhe/ose profesionale të saktësuar në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë.
2. Komisioni vlerësues profesional pran AK ka vlerësuar, ekzaminuar dhe trajtuar secilen ofertë konform kritereve të parapara në FDT, në ofertet e Ankuesit ka konstatuar se te Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 Kapaciteti teknik dhe professional Dëshmia 4 NUK plotësohet për faktin se Grupi i OE – Ankuesi Nuk ka prezentuar fare këtë Dëshmi e cila është kërkes e pa kontestueshme e AK.

3. A.K. vlerëson se duke marrë këtë vendim ka pasur parasysh dhe mbrojtjen e parimit " VLERA PËR PARANË", duke vlerësuar dhe respektuar fillimisht dispozitat ligjore lidhur me procesin e Ekzaminimit, Vlerësimit dhe Krahasimit të tenderëve duke marrë për bazë dhe transparencën, Trajtimin e barabartë të O.E.

Nga sa u tha me lartë, e në pajtim me nenin 62 paragrafi 62.1 pika pika (d) të Rregullores nr.001/2022 për Prokurimin Publik për paraqitje të kërkesë për rishqyrtim, A.K. vlerëson se nuk ka asnjë arsye të vendosë ndryshme nga ajo që është thënë si më lartë, andaj dhe është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Udhëzim Juridik:

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur dispozitat e LPP-së apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë të parashtroni Ankesë pranë OSHP-së (Organit Shqyrtues për Prokurim Publik), në bazë të nenit 109 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

**Autoriteti Kontraktues - Drejtoria për Prokurim Publik
K.R. nr. 358-2024 - datë 24/06/2024**



Drejtoria për Prokurim Publik

Ilmi Azemi
Ilmi Azemi

Vendimi dërgohet

1. 1x Palës
2. 1 x DKP
3. 1 x Arkivi (1 kopje)